



Projekti "Deakada e përkatësisë – Festojmë diversitetin" i finansuar nga Unioni Europian përmes IPA Instrumenti i Shoqërisë Civile dhe Programi i Medias 2014, Mbështetje për Shoqërinë Civile Organizatat nën Veprimin e Shoqërisë Civile dhe Lirinë e Medias në 2014, Linjë Buxhetore: 22.020401, Referenca: EuropeAid / 136-992 / DD / ACT / MK

KONKURS

për kuzhinierë/shefa të kuzhinës; barista/njohës të kafesë; trajnues /prodhues produktesh ushqimore/sipërmarrës social/ profesionest për biznes të qëndrueshëm për aktivitetin "Java e Kulinarisë"

Kreativ dhe Aktiv - Struga dhe Agjencioni për Zhvillimi Lokal, për nevojat e projektit "Dekada e Përkatësisë - Festimi i Diversitetit" mirëpret kandidatë me aftësi dhe nga praktika të reja: kuzhinierë/shefa të kuzhinës; barista/njohës të kafesë; trajnues /prodhues produktesh ushqimore/sipërmarrës social/ profesionest për biznes të qëndrueshëm për aktivitetin "Java e Kulinarisë". Në kërkim të njerëzve që jetojnë dhe punojnë në mjedise tepër multikulturore, projekti ka angazhim të fortë për të mbështetur talente me përvojë dhe në zhvillim. Aktiviteti do të ofrojë mundësinë që pjesëmarrësit të reflektojnë mbi komunitat tona të synuara dhe të ndajnë praktikatat më të mira nga të jetuarit dhe të punuarit në shoqëri multietnike.

Gjendja aktuale e situatës në sektorin përkatës

Komunitetet lokale në rajonin jugperëndimor të Maqedonisë janë të ndarë përgjatë vijave etnike dhe nuk kanë mundësi të zhvillojnë bashkëveprimin e vërtetë dhe të rifitojnë besimin mes njëri-tjetrit. Megjithatë komunitat janë të vogla, hapësira sociale, siç janë kafenetë, restorantet, ngjarjet kulturore dhe sportive, janë të ndara në mënyrë etnike. Të rinjtë studiojnë në ndërrime të ndryshme dhe në këtë mënyrë ata nuk takohen dhe nuk mund ta kuptojnë njëri-tjetrin pasi që as nuk flasin gjuhët e njëri tjetrit. Duke organizuar veprime dhe ngjarje të përbashkëta që lidhen me çështjet e interesit të përbashkët, ne do të krijojmë hapësirën e nevojshme për ndërveprim dhe të fillojmë bashkëpunimin.

Ushqimi është një formë e rëndësishme për shpërndarjen e kulturës mes njerëz me prejardhje të ndryshme. Takimet bashkë dhe ndarja e ushqimit është gjëja më e përbashkët dhe e detyrueshme në pothuajse çdo vend në botë dhe të jesh në gjendje të përgatitësh një pjatë dhe ta ndash atë me njerëzit që vlerëson është një nga konceptet më universale sepse është rrënja e mbijetesës sonë. "Java Kulinare" ka për qëllim ta bëjë këtë, t'i mundësojë komunitetit të bashkohet dhe të ndajnë kulturën dhe trashëgiminë e tyre me anë të ushqimit dhe të ushqejnë njëri-tjetrin nëpërmjet ushqimit.

Qëllimi i përgjithshëm

Të përkujdeset për diversitetin e komuniteteve duke sjellur ata së bashku nëpërmjet ushqimit dhe traditës së kuzhinës.



Decade of Belonging-Celebrating Diversity

This project is funded by the European Union

1. Kuzhinierë/Shef kuzhine

* Qëllimet specifike:

- shkëmbimi i recetave me kuzhinierë të tjerë kombëtarë / ndërkombëtarë të përfshirë në aktivitet;
- të gatujë së bashku me kuzhinierët e tjerë kombëtarë / ndërkombëtarë dhe pjesëmarrësit për deri në 15 mysafirë të tjerë në aktivitet.

*Profili i ekspertëve:

- Të paktën një vit përvojë në fushën e kuzhinës;
- Shkathtësi të shkëlqyera gatimi;
- Njohuri për kuzhinën multikulturore;
- Të kenë aftësi për të kombinuar gatimimin tradicional me atë modern.

Dërgoni dokumentet e mëposhtme për të aplikuar:

- Letër interesi (përse doni të merrni pjesë, një përmbledhje e shkurtër e përvojës së punës në fushën e kërkuar, emëroni disa enë gatimi / ushqime që dini t'i gatuar mirë);
- Diploma / çertifikata / mirënjohje në fushën e kërkuar (nëse ka);
- Foto, web faqe, punëtori, trajnime, ngjarjet, etj., ose ndonjë provë tjetër për përvojat e mëparshme.

2. Baristë / Njohës të kafesë

*Qëllimet specifike:

- shkëmbimi i recetave për të ushqyer kulturën e komuniteteve të ndryshme që vijnë së bashku për të shijuar kafënë;
- trajniti dhe ndani përvojën se si gatuhet kafeja për 10 baristë.

* Profili i ekspertëve

- Së paku një vit përvojë si baristë;
- Shkathtësi të shkëlqyera bariste;
- Njohja e llojeve të ndryshme të kafesë dhe stilet e ndryshme të prodhimit të kafesë;

Dërgoni dokumentet e mëposhtme për të aplikuar:

- Letër interesi (përse doni të merrni pjesë, një përmbledhje e shkurtër e përvojës së punës në fushën e kërkuar);
- Diploma / çertifikata / mirënjohje në fushën e kërkuar (nëse ka);
- Foto, web faqe, punëtori, trajnime, ngjarjet, etj., ose ndonjë provë tjetër për përvojat e mëparshme.

3. Trajnues/Prodhues produktesh ushqimore/Sipërmarrës social/ Profesionistë për biznes të qëndrueshëm

*Qëllimet specifike:

- Të ndajnë dhe përsërisin praktikat e mira në terren;
- Të rritet ndërgjegjësimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira midis prodhuesve vendas / rajonal / kombëtar / ndërkombëtar dhe konsumatorëve në fushën e kulinarisë.

*Profili i ekspertëve



Decade of Belonging-Celebrating Diversity

This project is funded by the European Union

- Së paku 1 vit përvojë në këtë fushë;
- Ekspertizë në të paktën një nga fushat e kërkuara: Trajnues/Prodhuës produktesh ushqimore/Sipërmarrës social/ Profesionestë për biznes të qëndrueshëm.

Dërgoni dokumentet e mëposhtme për të aplikuar:

- Curriculum vitae (CV);
- Letër interesi;
- Diploma / çertifikata / mirënjohje në fushën përkatëse (nëse ka).

Gjuha e aplikimit:

Kërkesa, si dhe e gjithë korrespondenca dhe dokumentet që kanë të bëjnë me aplikimin e paraqitur nga aplikanti, duhet të shkruhen në gjuhën shqipe, maqedone ose/dhe angleze.

Vendndodhja dhe kohëzgjatja

Periudha e fillimit

Data e fillimit: 23-28 Qershor 2018. Pritet që kontributi nga kandidati i përzgjedhur do të mund të shpërndahen gjatë një periudhe prej 1 deri në atë maksimale prej 6 ditësh.

Aqjenda:

<i>Java Kulinare</i>		
Datat	Aktiviteti	Zgjidhni datën ku dëshironi të merrni pjesë
23 Qershor	Panairi i Ushqimit - Strugë	
24 Qershor	Historitë e suksesit si trashëgimi - Punëtori, Strugë	
25 Qershor	Një shije e harmonisë së Strugës - Gatim me komunitetin	
26 Qershor	Një shije e harmonisë së Kërçovës - Gatim me komunitetin	
27 Qershor	Një shije e harmonisë së Dibres - Gatim me komunitetin	
28 Qershor	Të ndajmë një kafe - Strugë	

Vendndodhja/et e aktiviteteve

Rajoni Jugperëndimor në Maqedoni (Strugë, Ohër, Dibër, Kërçovë, Debërc).

Informacion administrativ

Rregullimet e taksave dhe TVSH-së



Decade of Belonging-Celebrating Diversity

This project is funded by the European Union

Të gjitha projektet e financuara nga BE-ja janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Në asnjë rrethanë TVSH-ja nuk mund të paguhet nga një program i Komunitetit.

Pagesa

Për pjesëmarrësin ndërkombëtar, vlera e parashikuar për diem për individ është deri në 100 euro (akomodimi dhe ushqimi janë të përfshira në këtë çmim). Kostot e udhëtimit do të mbulohen deri në 240 euro vajtje-ardhje brenda Evropës.

Për pjesëmarrësin kombëtar / lokal, vlerësimi për diem për individ është deri në 70 euro (akomodim, ushqimi dhe shpenzimet e udhëtimit përfshihen në çmim).

Pagesa do të bëhet sipas marrëveshjes.

Proceset e aplikacioneve

Për t'u bërë bërë pjesë e ekipit të projektit, kandidatët e interesuar duhet të shkruajnë në info@creativeactive.org.

Data e mbylljes për aplikacionet është **7 qershor 2018**.

Kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes

Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve në kuadër të projektit është përgjegjësi e partnerëve në zbatimin e projektit. Aplikimi i paplotë dhe aplikimet që nuk plotësojnë kriteret e pranimit do të refuzohen vetëm mbi këtë bazë. Të gjitha dokumentet e dorëzuara nga aplikuesit do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

Seksioni	Pikë
1. Curriculum vitae (CV) / Letër e interesit	50
2. Foto, web faqe, punëtori, trajnime, ngjarjet, etj., ose ndonjë provë tjetër për përvojat e mëparshme	30
3. Diploma / çertifikata / mirënjohje në fushën e kërkuar (nëse ka)	20
Rezultati total maksimal	100

Aplikacionet do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit në datë 08.06.2018, në ora 12.00, në zyrat e projekteve në Social Club KOMBINATI Strugë.



Decade of Belonging-Celebrating Diversity

This project is funded by the European Union



Njoftim për aplikantët

Të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në thirrje, do të njoftohen me shkrim për rezultatet e procedurës së përzgjedhjes.

Autoriteti Kontraktues

OJQ Kreative dhe Aktive, Strugë, adresa str.Turisticka bb, Struga, www.creativeactive.org



Decade of Belonging-Celebrating Diversity

This project is funded by the European Union